

AKT THEMELIMI

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Sabdora Marina” SHPK

ORTAKËT E SHOQËRISË

1. **Saide Hoxha**, e bija e Samedin – it, lindur në Kuçovë, datë 28.03.1957, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike, mbajtëse e kartës së identitetit me numër 034786895 dhe numër personal F75328092U,
2. **Ardita Kurti**, e bija e Rakip – it, lindur në Hotolisht, datë 14.04.1993, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike, mbajtëse e kartës së identitetit me numër 033308975 dhe numër personal J35414019W,

Sot më datë 04.01.2023, mbështetur në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjin nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, dhe në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, shtetasit e mësipërm, nëpërmjet kësaj akt marrëveshje shprehin vullnetin e tyre për të themeluar dhe për të qënë ortakët e shoqërisë si më poshtë:

Emri, selia, kohëzgjatja, objekti

Neni 1. Shoqëria është emërtuar “Sabdora Marina” sh.p.k.

Neni 2. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e së cilës rregullohet nga kjo kontratë, Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Neni 3. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Twin Towers, Qendra tregtare, Kati 2, Nr.30.

Neni 4. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të shkurtohet me vendim të Asamblesë së ortakëve. Shoqëria “Sabdora Marina” sh.p.k. gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5. Shoqëria “Sabdora Marina” sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj sipas këtij objekti: Shërbime të avokatisë, shërbime konsulente në çështje ligjore, financiare, në fushën e tatim taksave, në fushën administrative brenda dhe jashtë vendit, përfaqësim në gjykatë në të gjitha nivelet, përpara organeve të tjera shtetërore dhe institucioneve të tjera. Ndërmjetësim dhe zgjidhje të konflikteve

gjqësore me marrëveshje. Organizimi dhe kryerja e trajnimeve në fushën e së drejtës, kombëtare dhe ndërkombëtare. Shërbime të përkthimit të gjuhëve të huaja, anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, gjermanisht dhe gjuhë të tjera të huaja. Ofrim i shërbimeve të rekrutimit për kandidatë dhe biznese. Ofrim i shërbimeve të menaxhimit të burimeve njerëzore. Rekrutim punonjësish, brenda dhe jashtë vendit. Konsulencë të fushave të ndryshme si emigracioni, burime njerëzore, marketing, menaxhim, shitje etj. Trajnime financiare, menaxheriale, burime njerëzore etj. Ndërmjetësim stafi, rekrutimi, komisionimi. Staf leasing. Agjensi punësimi. Përgatitje dokumentash, përfaqësim dhe dorëzim dokumentash në institucionet përkatëse. Ndërmjetësim stafi të përhershëm dhe të përkohshëm. Sondazhe dhe trajnime të ndryshme. Agjenci imobiliare, shërbime real estate, blerje-shitje e pasurive të paluajtshme, ndërmjetësim për dhënie apo marrje me qera e pasurive të paluajtshme. Vlerësim i pasurive të paluajtshme duke përfshirë gjithçka sipas ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme si: ndërtesa civile e publike, apartamente, ndërtime të ndryshme teknologjike e industriale, hotele, pika karburanti, qendra biznesi, toka arë, troje, livadhe, kullota, si dhe pasuri të ndryshme që nuk bëjnë pjesë në pasuritë e patundshme si makineri e pajisje, automjete, pajisje pune në fabrika e ndërmarrje të tjera. Agjenci udhëtimesh, shërbime guidë-përkthyes, hotelerie, bar-bufë, restorant, transport udhëtarësh e taksi, makina me qera. Supervizim të fluturimeve, shërbime aeroportuale. Shitje të biletave të transportit ajror, detar dhe toksor si dhe prerjen e policave të siguracioneve të ndryshme. Shitje harta, guida revista, libra turistike, arkeologjike dhe historike. Import-eksport dhe tregëtim i artikujve të ndryshëm, ushqimorë, drithëra, prodhime deti, prodhime mishi, kafe, sheqer, kakao, vanilje, industrialë, bujqësorë, frutorë, materiale hidraulike, elektrike, hidrosanitare, elektroshtëpiake, makineri, mjete të ndryshme, etj. Transport brenda dhe jashtë vendit. Investime dhe financime të ndryshme. Shitje me shumicë dhe pakicë artikujsh ushqimorë, industrialë, bujqësorë, frutorë, mobilje, aksesorë, lekure, etj. Shërbim për zhvendosje mallrash. Shitje mallrash dhe shërbimesh online. Bashkëpunim me subjekte të ndryshme tregtare, vendas apo të huaj, për realizimin e objektit të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

Neni 6. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj tregtar si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj.

Neni 7. Selia e shoqërisë mund të ndryshojë dhe të transferohet ose shoqëria mund të vendosë për të patur edhe vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit përveç selisë kryesore.

Neni 8. Kapitali i shoqërisë është në shumën 10.000 (dhjetë mijë) Lek e ndarë në 2 kuota me vlerë: quota e parë 4.900 (katër mijë e nëntëqind) Lek dhe quota e dytë 5.100 (pesë mijë e njëqind) Lek. Kuotat zotërohen nga secili prej ortakëve të shoqërisë sipas kësaj ndarje:

- Saide Hoxha zotëron 1 kuotë me vlerë 4.900 (katër mijë e nëntëqind) Lek që përben 49% të kapitalit të shoqërisë,
- Ardita Kurti zotëron 1 kuotë me vlerë 5.100 (pesë mijë e njëqind) Lek që përben 51% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 9. Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me subjekte të tjera tregtare, shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërisë.

Neni 10. Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me ligjin shqiptar ose të huaj.

Administrimi

Neni 11. Në shoqërinë “Sabdora Marina” SHPK administrator i shoqërisë do të jetë:



Dolorjan Hoxha, i biri i Daut – it, lindur në Kuçovë, më datë 21.05.1979, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike, mbajtës i kartës së identitetit me numër 034749004 dhe numër personal H905210020.

Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh financiare. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Mbyllja dhe likuidimi i shoqërisë

Neni 12. Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me të gjitha rastet që parashikohen në ligj dhe në Statutin e shoqërisë. Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.


Neni 13. Në rastin e likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Ortakëve emëron likuidatorin dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në çastin e miratimit të bilancit të likuidimit. Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në varësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë dhe të filialeve të saj dhe fondet financiare i kalojnë Ortakëve, pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

Tiranë, datë 04.01.2023

ORTAKËT E SHOQËRISË

“Sabdora Marina” SHPK

Saide Hoxha



Ardita Kurti

